

V E N D I M
Nr. 85, datë 13.2.2003

**PËR LIDHJEN E KONTRATAVE, NDËRMJET INSTITUTIT TË SIGURIMEVE TË
KUJDESIT SHËNDETËSOR DHE FARMACIVE E DEPOVE TË BARNAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26 e 36 të ligjit nr. 7870, datë 13.10.1994 "Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar me propozimin e Ministrisë të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, për mbulimin e një pjese të çmimit të barnave, lidh kontratë me depot e barnave dhe me farmacitë e rrjetit të hapur, që shprehin interes për t'u përfshirë në skemën e sigurimeve shëndetësore.

2. Këshilli Administrativ i ISKSH-së përcakton kriteret, që duhet të përmbushin depot e barnave dhe farmacitë e rrjetit të hapur, për të kontraktuar me këtë institut.

3. Këshilli Administrativ i ISKSH-së miraton kontratën tip për farmacitë dhe depot e barnave dhe afatet kohore të lidhjes së tyre.

4. Të gjitha farmacitë, që kanë kontratë me ISKSH-në, janë të detyruara të tregtojnë barna vetëm me recetë të mjekut, me përjashtim të barnave që tregtohen pa recetë, sipas listës së miratuar nga Ministri i Shëndetësisë.

5. Të gjitha farmacitë, që kanë kontratë me ISKSH-në, janë të detyruara të tërheqin barnat e rimbursueshme të listës, vetëm në depot e barnave që kanë kontratë me këtë Institut.

6. Depot e barnave, që kanë kontratë me ISKSH-në, duhet të zbatojnë çmimet e depot për barnat e listës.

7. Dokumentacioni për qarkullimin e barnave nga depot të mbahet sipas formateve të miratuara nga Ministri i Financave dhe Ministri i Shëndetësisë.

8. ISKSH-ja pajis mjekët me receta me rimbursim dhe parimbursim, si dhe përcakton rregullat për administrimin e tyre.

9. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe ISKSH-ja për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano